



GREEN Solution

Tirana, Albania. Tel: +355 69 83 90 970

**NJOFTIM PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETIT, SUBJEKT I LEJES
MJEDISORE TIPI A OSE B DHE INFORMACION PËR NDIKIMET NË
MJEDIS**

**KLASIFIKIMI I AKTIVITETIT SIPAS LIGJIT NR. 10448, DATË 14.07.2011 "PËR LEJET E
MJEDISIT", I NDRYSHUAR, SHTOJCA I, INDUSTRIA ENERGJITIKE. ID 1.7 "GAZ NATYROR
AROMATIK OSE GNL PËRVEÇ RASTEVE KUR VEPRIMTARIA ESHTË LIDHUR ME TIPIN A, OSE
PËRZIERJE E AROMAVE DHE ID 1.10 FURNIZIM ME KARBURANT I MAKINAVE NË NJË
STACION TË FURNIZIMIT ME KARBURANT NË ZONAT URBANE.
(NDRYSHIM I KUSHTEVE TË LEJES MJEDISORE TIPI B ME NR.PN-1642-02-2023)**

VENDODHJA:

**QARKU VLORË, BASHKIA VLORË, LAGJJA KUSHTRIMI, RRUGA "DERVISH
HEKALI", OBJEKT NR.34/171**

Kërkues: Subjekti "DORI GAZ" Sh.p.k

NIPT: L67001201K

Për subjektin kërkues:

Për studion e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis:

"DORI GAZ" Sh.p.k

"GREEN Solution"

Viosina Gogo

Laert Shehu

Administrator

Administrator

DORI GAZ SHPK
L67001201K
VLORË - ALBANA

Shtator, 2023



Ky raport hartohet ne perputhje me Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja". Kreu VI, Informimi dhe pjesëmarrja e publikut për aplikimin për leje mjedisi të tipit A dhe B.

STRUKTURA E RENDITJES DHE PËRMBAJTES SË KËTIJ RAPORTI ËSHTË SI MË POSHTË:

TABELA E PËRMBAJTJES

| | | |
|-----|---|----|
| 1. | | |
| 2. | INFORMACION NËSE KËRKESA DO TË JETË PËR "APLIKIM PËR LEJE MJEDISI TË TIPIT A OSE TË TIPIT B" APO "APLIKIM PËR NDRYSHIM THELBËSOR NË KUSHTET E LEJES SË MJEDISIT TË TIPIT A OSE TË TIPIT B"; | 3 |
| 3. | TË DHËNAT E EKSTRAKTIT TË QKR-SË; | 4 |
| 4. | ADRESËN E VENDNDODHJES SË INSTALIMIT; | 6 |
| 5. | PËRSHKRIMIN E VEPRIMTARISË QË PARASHIKOHET TË ZHVILLOHET NË INSTALIM; | 7 |
| 6. | NJË PËRSHKRIM TË ELEMENTEVE TË LISTUARA NË FORMULARIN INFORMUES; | 7 |
| 7. | PËRMBLEDHJEN JOTEKNIKE TË RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS NË NIVEL KOMBËTAR OSE NDËRKUFITAR, KUR KËRKOHET PROCEDURA E VNM-SË; | 25 |
| 8. | KONSULTIMET NDËRKUFITARE, KUR KËRKOHET SIPAS LEGJISLACIONIT NË FUQI; | 25 |
| 9. | AUTORITETIN VENDIMMARRËS PËR DHËNIEN E AKTIT TË MIRATIMIT TË LEJES SË MJEDISIT, PROCEDURAT DHE AFATET QË DO TË NDIQEN; | 26 |
| 10. | ADRESËN E AKM-SË, KU PUBLIKU MUND TË DËRGOJË KOMENTET DHE SUGJERIMET E TIJ, ME SHKRIM APO NË FORMË ELEKTRONIKE, BREnda 20 (NJËZET) DITËVE NGA DATA E NJOFTIMIT; | 27 |

HYRJE

Ky raport hartohet me kerkese te subjektit "DORI GAZ" Sh.p. k, me NIPT: L67001201K, me seli ne: Vlore, Vlore, Lagjja Kushtrimi, Rruga Dervish Hekali, Objekt nr.34/171 dhe administrator Znj. Viosina Gogo. Ky subjekt, paraqitet ne cilesine e subjektit zhvillues te aktivitetit dhe si investitor i ketij instalimi.

Objekti i ketij raporti eshte aktiviteti i industrise energjitike: ID 1.7 "Gaz natyror aromatik ose GNL pervec rasteve kur veprimtaria eshte lidhur me tipin A, ose perzierje e aromave dhe ID 1.10 Furnizim me karburant i makinave ne nje stacion te furnizimit me karburant ne zonat urbane. Aktiviteti do te zhvillohet ne nje objekt ekzistues, i ndodhur ne Qarku Vlore, Bashkia Vlore, lagjja Kushtrimi, rruga "Dervish Hekali", Objekt nr.34/171.

Ky njoftim per zhvillimin e aktivitetit, subjekt i lejes mjedisore tipi B dhe informacion per ndikimet ne mjedis hartohet per ndryshimin e kushteve te lejes mjedisore ekzistuese te tipit B me numer PN-1642-02-2023, date 13.02.2023, ku subjekti eshte i pajisur me leje mjedisore dhe kerkojme zgjerim te kapacitetit te depozites GLN (Gaz i lengshem i naftes) ne aktivitetin ekzistues "Gaz natyror aromatik ose GNL pervec rasteve kur veprimtaria eshte lidhur me Tipin A, ose perzierjee aromave" me vendodhje: "Qarku Vlore, Bashkia Vlore, Lagjja Kushtrimi, Rruga "Dervish Hekali", Objekt nr.34/171". Ndryshimi qe propozohet te kryhet eshte zgjerimi i kapacitetit te depozites GLN, pra nga nje depozite me kapacitet 4900 litra, do te zvendesohet duke u instaluar nje depozite me kapacitet 8900 litra. Pervec ndryshimit te kapacitetit te depozites nuk ka asnje ndryshim tjetër ne teknologji, sipërfaqe, koordinata dhe vendodhje të aktivitetit. Depozita e re qe do te instalohet ndodhet brenda siperfaqes se ushtrimit te aktivitetit per te cilen operatori disponon leje mjedisore te tipit B.

- **INFORMACION NËSE KËRKESA DO TË JETË PËR "APLIKIM PËR LEJE MJEDISI TË TIPIT A OSE TË TIPIT B" APO "APLIKIM PËR NDRYSHIM THELBËSOR NË KUSHTET E LEJES SË MJEDISIT TË TIPIT A OSE TË TIPIT B".**

Aplikim per ndryshim te leje se mjedisi te tipit B me numer PN-1642-02-2023, date 13.02.2023. Nënkatgoria e lejes sipas sistemit te lejeve/licencave eshte III.1.B.

Klasifikimi i aktivitetit sipas ligjit nr. 10448, date 14.07.2011 "per lejet e mjedisit", i ndryshuar, Shtojca I,

- Industrite energjetike:

ID 1.7. Gaz natyror aromatik ose GNL pervec rasteve kur veprimtaria eshte lidhur me tipin A, ose perzierje e aromave

ID 1.10 Furnizim me karburant i makinave ne nje stacion te furnizimit me karburant ne zonat urbane.

Vendodhja: **Qarku Vlore, Bashkia Vlore, lagjja Kushtrimi, rruga "Dervish Hekali", Objekt nr.34/171.**

▪ TË DHËNAT E EKSTRAKTIT TË QKR-SË;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

**EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË
DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR"**

GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | |
|---|--|------------------|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | L67001201K | |
| 2. Data e Regjistrimit | 01/08/2016 | |
| 3. Emri i Subjektit | DORI GAZ | |
| 4. Forma ligjore | SHPK | |
| 5. Data e themelimit | 29/07/2016 | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 29/07/2016 | |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Vlore Vlore Lagjja Kushtrimi, Rruga Dervish Hekali, Objekt nr.34/171 | |
| 8. Kapitali | 1.000.000,00 | |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 1,00 | |
| 9. Objekti i aktivitetit | Pikë depozitimi dhe tregëti me pakicë gazi i lëngët. Tregtim me pakicë i gazit të lëngshëm me bombola. Tregti aksesorë dhe pajisje të tjera për gazin. | |
| 10. Administratori/ët | Viosina Gogo | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 31/01/2020 | Deri: 31/01/2025 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Ortakët | DorjanGogo | |
| 12.1 Vlera e kapitalit | Para: 1.000.000,00 | Natyre: |
| 12.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 100,00 | |
| <i>*Të përfuqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një</i> | | |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

| | |
|--|--|
| <i>kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i> | |
| 12.4 Komente (nëse ka) | |
| 13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | |
| 14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: DORI GAZ E-Mail: dorigaz89@gmail.com Telefon: 0697233564 |
| 15. Statusi: | Aktiv |

[Lista e Dokumenteve:](#)

[Statuti \(nese eshte hartuar si dokument i ndryshem nga akti i themelimit\)](#)

Regjistrimi Fillestar: CN-854060-07-16

HISTORIKU I REGJISTRIMIT

| Data e regjistrimit | Ndryshimi i te dhenave te regjistruara |
|---------------------|--|
| 12/08/2016 | <p>Numri i ceshtjes: CN-875433-08-16 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitim i Vendimit te Ortakut dt. 11.08.2016 per ndryshim adrese kryesore.</p> <p><u>Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme ne Adresat e Aktivitetit:</u> eshte Shtuar Adresa: "Vlore; VLORE; Vlore; ; VLORE; Lagjja Kushtrimi, Rruga Dervish Hekall, Objekt nr.33/411; " eshte Hequr Adresa: "Vlore; VLORE; Vlore; ; VLORE; Lagjja Kushtrimi, Rruga 100 Vjetori i Pavarësisë, Objekt Nr.101/2; "</p> <p><u>Lista e Dokumenteve:</u> Vendim i asamblese se pergjithshme</p> |
| 01/08/2017 | <p>Numri i ceshtjes: CN-411074-07-17 (APLIKIM PER DEPOZITIM PASQYRA FINANCIARE) Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i pasqyrave financiare per vitin 2016.</p> <p><u>Lista e Dokumenteve:</u> Akti i miratimit te bilancit nga asambleja subjektit, ose nga individi tregtar Pasqyra e ardhurave dhe të shpenzimeve</p> |

▪ **ADRESËN E VENDNDODHJES SË INSTALIMIT;**

Aktiviteti do te zhvillohet ne nje objekt ekzistues, i ndodhur Qarku Vlore, Bashkia Vlore, lagjja Kushtrimi, rruga "Dervish Hekali", Objekt nr.34/171.

Pozicionimi i objektit ne ortofoto



▪ **PËRSHKRIMIN E VEPRIMTARISË QË PARASHIKOHET TË ZHVILLOHET NË INSTALIM;**

Subjekti "DORI GAZ" Sh.p. k, me NIPT: L67001201K, me seli ne: Vlore, Vlore, Lagjja Kushtrimi, Rruga Dervish Hekali, Objekt nr.34/171 dhe administratore Znj. Viosina Gogo. Ky subjekt, paraqitet ne cilesine e subjektit zhvillues te aktivitetit dhe si investitor i ketij instalimi.

Objekti i ketij raporti eshte aktiviteti i industrise energjitike: ID 1.7 "Gaz natyror aromatik ose GNL përveç rasteve kur veprimtaria eshte lidhur me tipin A, ose përzierje e aromave dhe ID 1.10 Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane. Aktiviteti do te zhvillohet ne nje objekt ekzistues, i ndodhur ne Qarku Vlore, Bashkia Vlore, lagjja Kushtrimi, rruga "Dervish Hekali", Objekt nr.34/171.

▪ **NJË PËRSHKRIM TË ELEMENTEVE TË LISTUARA NË FORMULARIN INFORMUES;**

INFORMACION MBI KËRKUESIN/OPERATORIN

Informacion i Përgjithshëm

| | |
|---|---|
| Emri i Kompanisë | DORI GAZ |
| Statusi Ligjor | Shoqëri me Përgjegjesi te Kufizuar |
| Ortakët/Aksionerët e Kompanisë(sipas Ekstraktit të lëshuar nga QKR) | Dorjan Gogo (100% te aksioneve dhe kapitalit) |
| Adresa e zyrës qendrore të Kompanisë | Selia: Vlore, Vlore, Lagjja Kushtrimi, Rruga Dervish Hekali, Objekt nr.34/171 |
| Adresa postale e Kompanisë, nqse ndryshon nga adresa e mësipërme | Nuk ndryshon |
| Numri i rregjistrimit të Kompanisë(NIPT) | L67001201K |
| Kodi kryesor i aktivitetit (sipas kollonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit nr 10448, date 14.7.2011 "Per lejet e mjedisit") | Industriose energjitike: ID 1.7 dhe ID.1.10 |
| Kodi SNAP | Nuk ka kod SNAP |
| Kodi NOSE-P | Nuk ka kod NOSE |
| Numri i Punonjësve | 2 individe |
| Përfaqësuesi i autorizuar Emri dhe Mbiemri | Viosina Gogo |
| Pozicioni në Kompani | Administrator |
| Telefoni | 0697233564 |
| Faksi | Nuk ka |
| E-mail | dorigaz89@gmail.com |

Informacion mbi instalimin/impianitin

| | | | |
|--|--|-------------------|-------------------|
| Emri i instalimit/impianitit | Industrise energjitike: | | |
| Adresa ku ndodhet apo do të ngrihet instalimi/impianiti | Qarku Vlore, Bashkia Vlore, lagjja Kushtrimi, rruga "Dervish Hekali", Objekt nr.34/171. | | |
| Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4 | Koordinatat e gjeneruara nga portali asig.gov.al | | |
| | Pikat | X | Y |
| | 1 | 4483866.15 | 4371427.75 |
| | 2 | 4483862.41 | 4371412.02 |
| | 3 | 4483873.22 | 4371409.62 |
| | 4 | 4483881.74 | 4371411.26 |
| Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4 | 5 | 4483885.09 | 4371424.74 |
| | -ID 1.7 Gaz natyror aromatik ose GNL perveç rasteve kur veprimtaria eshte lidhur me tipin A, ose perzierje e aromave, Kapaciteti kufi per lejet e tipit B: Te gjitha instalimet, ID 1.10 Furnizim me karburant i makinave ne nje stacion te furnizimit me karburant ne zonat urbane, Kapaciteti kufi per lejet e tipi B: Te gjitha instalimet | | |
| Kapaciteti i projektuar | Kapaciteti i depozites: 8900 litra GLN (1 Depozite gazi) | | |

Tabela në vijim përfshin listën e të gjithë lejeve, liçensave, autorizimeve të përfutuara në datën e dorëzimit të Formularit të kërkesës.

| Leja, Liçensa, Autorizimi | Nr. Ref. | Data e Lëshimit | Periudha e vlefshmërisë |
|---------------------------|-----------------|-----------------|-------------------------|
| Leje Mjedisi tipi B | PN-1642-02-2023 | 13/02/2023 | Pa afat |

Informacioni mbi personin e kontaktit të autorizuar nga administratori në lidhje me lejen

| | |
|----------------------|---|
| Emri dhe Mbiemri | Viosina Gogo |
| Adresa | Vlore, Vlore, Lagjja Kushtrimi, Rruga Dervish Hekali, Objekt nr.34/171, |
| Pozicioni në kompani | Administrator |
| Telefoni | 0697233564 |
| Faksi | Nuk ka |
| E-mail | dorigaz89@gmail.com |

Pronësia e tokës

| | |
|---|--|
| Emri dhe mbiemri i pronarit/pronarëve | Z. Piro Goga |
| Të dhëna për pronësinë e tokës sipas dokumentit të lëshuar nga ZRPP. | Zona Kadastrale Nr. 8605, numri i pasurisë 34/171. Siperfaqja totale e pronës 309.67m ² nga e cila 309.67m ² është truall dhe 77m ² është ndertesa. |
| Adresa | Vlore |
| Informacion për kontratën e qerasë nëse ka Nr. i kontratës së qerasë nëse kërkuesi nuk është pronar i tokës deri në këtë moment | Ne përdorim nga subjekti |

Pronësia e impiantit

Emri dhe adresa e pronarit të impiantit ku kryhet aktiviteti, si dhe informacion mbi kontratën e qerasë nëqoftëse kërkuesi nuk është pronari i impiantit.

| | |
|--|---|
| Emri dhe mbiemri i pronarit/pronarëve | DORI GAZ shpk |
| Adresa | Qarku Vlore, Bashkia Vlore, Lagjja Kushtrimi, Rruga Dervish Hekali, Objekt nr.34/171, |
| Informacion mbi kontratën (qeradhënësi dhe qeramarrësi, afati i kontratës, mënyrat e përfundimit të kontratës; periudha e vlefshmërisë) Bashkëngjisni një kopje të kontratës së qerasë | Nuk ka kontrate |

Informacion në lidhje me ndryshime të konsiderueshme të propozuara të lejes së tipit b për një instalim/impianit ekzistues

Operatori/kërkuesi plotëson tabelën e mëposhtme vetëm kur kërkon ndryshime të kushteve të lejes së mjedisit të Tipit B, për një instalim/impianit ekzistues.

| | |
|---|--|
| Emri i impiantit (sipas lejes ekzistuese të mjedisit) | Leje mjedisore e tipit B për: "Gaz natyror aromatik ose GNL përvec rasteve kur veprimtaria është lidhur me Tipin A, ose perzierjee aromave; Furnizim me karburant I makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane". |
| Data e dorëzimit të kërkesës për ndryshime të lejes së lëshuar të mjedisit të Tipit B | Kerkese protokolluar pranë AKM me Nr. 8198 Prot, date 03.10.2023. |
| Data dhe numri i lejes ekzistuese të mjedisit, të Tipit B, (refero Nr.e identifikimit të Lejes sipas Regjistrimit të AKM) | Leje Mjedisore Nr. PN-1642-02-2023, Nr. 1069 Prot, Nr. i identifikimit të Lejes 4389, K.Nr.18, datë 13.02.2023, sipas Akt-Miratimit të Lejes së Mjedisit Tipi B. |
| Vendodhja e impiantit/ instalimit (qarku/ bashkia/komuna, numri kadastral) | Qarku Vlore, Bashkia Vlore, Lagjja "Kushtrimi", Rruga "Dervish Hekali, objekt nr.34/171 (Nuk ka ndryshim të adresës dhe vendodhjes) |
| Arsyeja/arsyet për ndryshimin e kërkuar në lejen e mjedisit | <p>Aplikim i bere sipas Kreut V, Seksioni 1, Ndryshim i Kushteve të Lejeve Mjedisore Ekzistuese të Tipit A dhe B, për pershtatjen me Shtojcën 1, të Ligjit Nr. 52/2020, datë 30.04.2020 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit", ku për nevojat e aktivitetit të shoqërisë, kërkohet që brenda sipërfaqes ekzistuese të aktivitetit, zgjerohet kapaciteti i depozitës së GLN-së (Gaz i lëngshëm i naftës). Ndryshimi që propozohet të kryhet është zgjerimi i kapacitetit të depozitës GLN, pra nga një depozitë me kapacitet 4900 litra, do të zvëndësohet duke u instaluar një depozitë me kapacitet 8900 litra.</p> <p>Përveç ndryshimit të kapacitetit të depozitës nuk ka asnjë ndryshim tjetër në teknologji, sipërfaqe, koordinata dhe vendodhje të aktivitetit. Depozita e re që do të instalohet ndodhet brenda sipërfaqes së ushtrimit të aktivitetit për të cilën operatori disponon leje mjedisore të tipit B.</p> |

PËRSHKRIMI I INSTALIMIT, NJËSITË E TIJ TEKNIKE DHE AKTIVITETET /VEPRIMTARITË E LIDHURA DREJTPËRDREJT ME TË.

Subjekti "DORI GAZ" Sh.p.k, me NIPT: L67001201K me seli ne: Vlore, Vlore, Lagjja Kushtrimi, Rruga Dervish Hekali, Objekt nr.34/171 dhe administrator Znj. Viosina Gogo. Ky subjekt, paraqitet ne cilesine e subjektit zhvillues te aktivitetit dhe si investitor i ketij instalimi.

Objekti i ketij raporti eshte aktiviteti i industrise energjitike: ID 1.7 "Gaz natyror aromatik ose GNL perveç rasteve kur veprimtaria eshte lidhur me tipin A, ose perzierje e aromave dhe ID 1.10 Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane. Aktiviteti do te zhvillohet ne nje objekt ekzistues, i ndodhur ne Qarku Vlore, Bashkia Vlore, lagjja Kushtrimi, rruga Dervish Hekali, Objekt nr.34/171.

PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Aktiviteti do te zhvillohet ne nje ambjent te pershtatshem per kete aktivitet duke mos krijuar deme apo efekte negative te ndryshme ne mjedisin perreth.

Vendi i zhvillimit te ketij aktiviteti eshte nje godine 1 kat i cili ndodhet ne nje zone te banuar te lagjes "Kushtrimi", Vlore.

Qëllimi i këtij aktiviteti është Impiant i tregetimit te gazit për perballimin e kerkesave te sektorit familjar dhe për makinat.

Brenda siperfaqes se veprimtarise jane te vendosura:

- Depozita siperfaqesore e magazinimit te GNL
- Rruge kalimi per furnizimin e rezervuarit te GLN-se
- Dhoma teknike e mbushjes dhe grumbullimit te bombulave te GLN-se
- Peshore elektronike
- Elektropompe centrifugale
- Ambientet e zyrave dhe higjenosanitare
- Sistemi i mbrojtjes nga zjarri

• Te dhenat mbi impiantin e instaluar

Shoqeria "DORI GAZ" shpk si firme me aktivitet ne fushen e veprimtarise "Gaz natyror aromatik ose GNL, ka investuar dhe disponon impiante/makineri te domosdoshme per zhvillim e proceseve kryesore.

Te dhenat teknike te projektit:

| | |
|--------------------|-------------------|
| Kapaciteti | 8900 litra |
| Numri i depozitave | 1 depozit |

Zona e depozitimit të gazit

Depozita e gazit GLN eshte llojit e metalik, i vendosur mbi siperfaqen e tokes, i fiksuar ne nje konstrukcion metalik dhe i mbeshtuetr ne bazament betoni me trashesi 50cm te forcuar me rrjete teli me lartesi 2m ne nje distance jo me pak se 1.5m nga faqet ansore te rezervuarit. Bashke me rezervuarin behet dhe instalimi i tokezimit me ane te nje elektrode tokezimi te ngulur ne toke.

Furnizimi i rezervuarit te GLN-se

Furnizimi i rezervuarit me GLN do te behet nepermjet autoboteve nga pika e shkarkimit te tyre nepermjet rrugeve te kalimit. ruge kalimi i autobotit ka gjeresi mbi 3.5 m dhe lejon afrimin e tij deri ne nje largesi prej 10 m afer rezervuarit. Lidhja me autobotin do te behet ne tubo fleksibel te pajisur ne valvolat perkatese si dhe me pince dhe percjell/s bakri qe lidhet me token, per mbrojtjen nga shkarkimet hidrostatike.

MENAXHIMI I INSTALIMIT

Rezervuari i GLN-se eshte vendosur ne nje vend te rrethuar dhe te mbrojtur nga kalimtarete dhe makinat. Depozita e gazit GLN eshte llojit e metalik, i vendosur mbi siperfaqen e tokes, i fiksuar ne nje konstrukcion metalik dhe i mbeshtuete ne bazament betoni me trashesi 50cm te forcuar me rrjete teli me lartesi 2m ne nje distance jo me pak se 1.5m nga faqet ansore te rezervuarit. Bashke me rezervuarin behet dhe instalimi i tokezimit me ane te nje elektrode tokezimi te ngulur ne toke. Energjia elektrike sigurohet nga rrjeti i zones. Uji sigurohet nga rrjeti i ujesjellesit, megjithese nuk konsumohet ne permasa te medha. Furnizimi i rezervuarit me GLN do te behet nepermjet autoboteve nga pika e shkarkimit te tyre. Lidhja me autobotin do te behet ne tubo fleksibel te pajisur me valvolat perkatese si dhe pince dhe percjalles bakrri qe lidhet me token, per mbrojtjen nga shkarkimet hidrostatike. Rruge kalimi i autobotit ka gjeresi mbi 3.5m dhe lejon afrimin deri ne nje largesi prej 10m afer rezervuarit.

Përsa i përket ambientit, ai eshte një ambient i pranueshem, me kushte higjene dhe sigurie teknike, në pikën e shitjes së gazit jane te instaluar bombula per shuarjen e zjarrit. Përsa i përket mjedisit rrethues të distributorit, i gjithë sheshi është i shtruar me beton për hidroizolim e tij nga depërtimi i ujit ose lëndëve të tjera të lëngshme.

Në objekt jane te vendosura tabela paralajmeruese dhe sensibilizuese të tilla, si ndalimi i përdorimit të duhanit, përdorimi i aparateve fotografik, mbajtja pastër e ambientit, etj.

Qëllimi i këtij aktiviteti është mbushja e bombulave me gaz te lenget te naftes (GLN) me kapacitet maksimal deri ne 15kg per konsumatore individual.

Aktiviteti do te zhvillohet ne nje ambjent te pershtatshem per kete aktivitet duke mos krijuar keshtu deme apo efekte negative te ndryshme ne mjedisin perreth.

Vendosja e Impiant i tregetimit te gazit ne kete zone eshte e pershtatshme per zhvillimin e ketij aktiviteti pasi eshte ne distance te konsiderueshme nga, objektet apo veprat hidroenergjetike, etj.

Furnizimi me energji elektrike

Aktualisht rrejtja i shpërndarjes së energjisë elektrike është në gjëndje mjaft të mire dhe kuadri elektrik është i plotësuar. Per mbrojtjen nga shkarkimet atmosferike eshte parashikuar nje rrjet tokezimi ne zonen e rezervuareve dhe sisteme tokezimi te veçanta per çdo pajisje.

Infrastruktura rrugore

Objekti ndodhet ne rrugen "Dervish Hekali". Rruga, e cila të dërgon në hyrje të objektit është ekzistuese dhe në gjëndje të mire e shtruar me asfalt, duke mundësuar levizjen e lire te mjeteve.

Gjithashtu pergjate gjithë gjatesise se infrastruktures se brendshme eshte ndertuar edhe rrjeti i drenazhimeve te ujrave te shiut.

Në afërsi të zonës ku zhvillon aktivitetin subjekti "DORI GAZ" Sh.p. k nuk ka vepra arti, argjinatura, linjë elektrike të tensionit të lartë që mund të dëmtohen nga zhvillimi i aktivitetit.

Vendodhja e objektit ne te cilin do te zhvillohet aktiviteti



LËNDËT E PARA DHE MATERIALET NDIHMËSE, MATERIALE TË TJERA DHE ENERGJIA E PËRDORUR OSE E GJENERUAR NË IMPIANT/INSTALIM

Lendet e pare blihet e gjitha nga subjekte te tjera te lincensuara per prodhimin e saj, kryesisht nga importi. Lënda e pare qe perdoret per kete aktivitet eshte gazi i lengshem i naftes dhe si lende ndihmese per ushtrimin e kativitetit eshte enrgjia elektrike dhe uji.

MENAXHIMI I MATERIALEVE

Aktiviteti qe zhvillon shoqeria " DORI GAZ" Sh.p. k, me NIPT: L67001201K, Pike gazit e ndodhur ne Qarku Vlore, Bashkia Vlore, lagjja Kushtrimi, rruga "Dervish Hekali", Objekt nr.34/171 nga proceset e ndryshme te operimit te punes ne objekt per magazinimin, shperndarjen dhe furnizimin me gaz te lengshem GLN dhe gjenerohet nje sasi mbetjesh.

Lendet e para/produktet qe perdoren ne kete aktivitet jane vetem Gazi i Lengshem i Naftes (kryesisht Propan), ndersa materia let ndihmese jane energjia elektrike. Persa i perkete menaxhimit te Gazit GLN, ruhet dhe magazinohet e tregtohet ne menyre te sigurte nga subjekti qe menaxhon kete aktivitet. Kjo do te thote se te gjitha enet qe perdoren, pra depozitat, jane ene te prodhuara per te punuar nen presion kaq te larte dhe jane te kolauduara nga Inspektoriati Qendror Teknik (IQT).

Ky sistem eshte i pajisur me valvula sigurie dhe te kontrollimit te presionit, duke shmangur keshtu shkarkimin e gazit ne atmosfere dhe duke krijuar sigurine tek punonjesit dhe klientet. Bombulat qe mbushen plotesojne kriteret baze te sigurise teknike dhe certifikohen per sigurine tyre vazhdimisht nga organet pergjegjese.

Mbetje të ngurta të tjera që prodhohen nga ndërtimi në kantier janë mbetjet e ngurta urbane nga aktiviteti human, te tilla si: plastike, qelq, leter-karton, metale, etj, te cilat do te depozitohen ne kontenieret e vendosur nga Njësia e Qeverisjes Vendore per kete qellim dhe do te terhiqen nga firma e pastrimit të territorit.

Aktiviteti nuk shkarkon mbetje te ngurta as te lengeta ne mjedisin e zones.

PROGRAMI I PERMIRESIMIT

Per vete karakteristikat e punes se objektit qe do te perdoret lende lehtesist te ndezshme, jane parashikuar te merren nje sere masash teknike dhe administrative per te siguruar mbrojtjen dhe sigurine e punes ne objekt:

- Rezervuari i GLN-se eshte vendosur ne nje vend te rrethuar dhe te mbrojtur nga kalimi i njerezve dhe mjeteve.
- Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike dhe elektrostatische: per kete qellim jane parashikuar lidhja me token e rezervuarit, si dhe lidhja me token e autobotit gjate shkarkimit te tij. Te gjitha pajisjet dhe materialet qe do te perdoren, duhet te jene te vertifikuara.
- Mbrojtja e ambientit nga ndotjet: gazi i lengezuar i naftes nuk perben impakt per ambientin dhe ekosistemin. Megjithate per vete kushtet e punes se tij si leng nen presion, aparaturat dhe pajisjet jane te tilla qe nuk lejojne absolutisht asnje njedhje. Pervec kesaj, ne rezervuar jane vendosur valvola fluksi dhe kontravalvola ne te gjitha konjeksionet e tij, me qellim bllokimin e menjehershem te rezervuarit per cdo rast te konstatimit te njedhjeve ne tubacionet dhe pajisjet.
- Pajisjet per mbrojtjen nga zjarri: per mbrojtjen nga zjarri eshte parashikuar te vendosen shuarese zjarri 5x9 kg me pluhur te thate dhe hundez 19 mm ne afersi te depozites se GLN-se dhe ne afersi te distributorit te GLN-se.

- **Mbrojtja nga zjarri**

Zjarret GLN, klasifikohen në zjarret e tipit C. Jane zjarre lëndësh djegese te gazta. Gazet si, gazi natyral që përdoret në familje, hidrogjeni, GLN, dhe metani jane lendet djegese te gazta. Lëndët me eficente per shuarjen e tyre jane shkuma dhe pluhurat.

Shkaqet e renies se zjarrit ne objekt

- Cigare
- Elektro-Statika
- Celulari
- Ndricimi dhe rrjeti elektrik i amortizuar
- Kryerja e saldimeve ne piken e gazit
- Bombulat per mbrojtjen nga zjarri
- Per te qene te sigurt se ne nje rast urgjent, bombula e fikesit te zjarrit

Bombulat per mbrojtjen nga zjarri

Për të qënë të sigurt se në një rast urgjent, bombula e fikësit të zjarrit me pluhur që ndodhet në pikën e gazit, do të jete funksionale, duhet që të mirëmbahet dhe testohet here pas here. Kontrolle periodike nga subjekti që kryen rimbushjen e tyre.

Për mbrojtjen nga zjarri përveç masave të marra në projektim sipas normave dhe kushteve teknike, janë parashikuar edhe vendosja e mjeteve zjarrëfikëse dhe sinjalistika përkatëse.

Sistemi i mbrojtjes nga zjarri

Për mbrojtjen nga zjarri përveç masave të marra në projektim sipas normave dhe kushteve teknike, janë parashikuar edhe vendosja e mjeteve zjarrëfikëse dhe sinjalistika përkatëse, si dhe pajisje si dedektore tymi, sinjal alarmi etj, shuarese zjarri 5x9 kg me pluhur të thate. Për hyrje-daljet e automjeteve dhe lëvizjen e tyre brenda stacionit janë parashikuar hapësira të mjaftueshme.

Objektivat afatshkurtra dhe afatmesme të planit janë si më poshtë:

- Instalimi i sistemit me 3-kontenier brenda zones ku zhvillohet aktiviteti
- Diferencimi i mbetjeve, sipas tre rrymave prioritare (Plastik, Letër/Karton dhe Mbetje të tjera)
- Transportimi i mbetjeve të ngurta urbane në vendepozitim të caktuar nga Njësia Vendore.

Synimet:

- Përmirësimi i cilësisë së mjedisit, grumbullimin e mbetjeve në të gjithë territorin e objektit dhe diferencimin e mbetjeve sipas tre rrymave kryesore
- Organizimi i diferencuar i mbetjeve në përputhje me politikat kombëtare, për të mundësuar dhe stimuluar metodat e trajtimit të mbetjeve (riciklimi dhe riperdorim)
- Planifikimi dhe ngritja në nivelin zonal i një rrjeti të kontenierëve për diferencimin e mbetjeve me qëllim për të maksimizuar dobinë e Landfillit Rajonal
- Maksimizimi i përdorimit të mbetjeve urbane dhe mbetjeve teknologjike

Legjislacioni Mjedisor per Menaxhimin e Mbetjeve

- Ligji Nr. 10463, date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", i ndryshuar.
- VKM Nr. 402, datë 30.6.2021 "Për Miratimin e Katalogut të Mbetjeve."

SHKARKIMET

Shkarkimet ne uje

Ujerrat që dalin nga aktiviteti janë ujera të cilat lindin si rrjedhojë e larjes dhe pastrimit të vazhdueshëm të ambjentëve të punës e në vecanti dyshemese. Përveç ujerave që shkarkohen nga larja dhe pastrimi ambjentëve, kemi dhe ujerrat e përdorura për qëllime sanitare. Ujerrat e pastrimit të ambjentit dhe ato sanitare shkarkohen në sistemin e kanalizimeve të zones. Ndikimi i këtij aktiviteti në ujera gjatë fazës së funksionimit do të konsistojë në ujerrat e pastrimit të ambjentit të punës.

Emetimet ne ajer

Emetimet ne ajer mund te vijne nga perhapja e gazit te lengshem ne atmosfere, si rrjedhoje e ndonje avarie ne sistem dhe ne valvolat e sigurise, ose nga aktiviteti i I shperndrjes dhe magazinimit te bombulave, gjithmone nje sasi e vogel clirohet ne ajer nga rezerva e pistoletes furnizuese. Gjithashtu te pranishme ne terminalet e shkarkimit jane edhe aromat e gazit (squfur), te cilat jane te pashmangshme edhe pse shoqeria ka marre masat e nevojshme per reduktimin ne maksimum te ketyre shkarkimeve.

Zhurmat dhe vibrimet

Zhurmat qe prodhohet ne objekt vijne kryesisht nga mjetet e transportit rrugor qe frekuentojne piken e furnizimit me gaz GLN si dhe mjetet e transportit gjate procesit te furnizimit te depozites me gaz GLN. Ne kete ambjent nuk vleresohen nivele te tilla zhurme dhe si rrjedhoje edhe keto masa nuk do te jene te nevojshme. Nuk shkaktohen vibrime.

Mbetjet e prodhuara

Mbetje të ngurta të tjera që prodhohen nga ndërtimi në kantier janë mbetjet e ngurta urbane nga aktiviteti human, te tilla si: plastike, qelq, leter-karton, metale, etj, te cilat do te depozitohen ne kontenieret e vendosur nga Njësia e Qeverisjes Vendore per kete qellim dhe do te terhiqen nga firma e pastrimit të territorit.

Aktiviteti nuk shkakton mbetje te ngurta as te lengeta ne mjedisin e zones.

REDUKTIMI I SHKARKIMIT DHE SISTEMET E KONTROLLIT

Masa të tjera lehtësuese, për funksionimin eficient dhe të sigurtë të punës në aktivitetin e furnizimit per mbushje gazi GLN:

- Të mirëmbahen mjediset e gjelbëruar në mënyrë të përhershme dhe të mbillen edhe bimë dekorative autoktone në kushte artificiale për të rritur koeficientin e gjelbërimit.
- Të shmanget në maksimum perdorimi i mjeteve të transportit kur nuk është e nevojshme dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.
- Të kryhet rrethimi i objektit dhe linjës së magazinimit dhe furnizimit te GLN si dhe të vendosen tabela paralajmëruese për rreziqet për kalimtarët dhe punonjësit.
- Të reduktohet qarkullimi në orët e pikut të trafikut, për të mos krijuar trafik të rënduar në zonë.
- Të mos përdoren boritë e mjeteve në qendrat e banuara dhe qarkullimi të kryhet me shpejtësi të ulet.
- Të vendosen kontenier për mbajtjen pastër të ambjenteve nga mbetjet urbane për numrin e punonjësve.
- Investitori të respektojë detyrimet e vendosura në Lejen Mjedisore që do të miratohet nga AKM.
- Subjekti të respektojë të gjitha masat/normat/planet/shkarkimet e deklaruar në këtë Formular-Kërkese për Leje Mjedisore Tipi B.
- Subjekti të jetë në dijeni dhe të azhurnohet për kuadrin ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.

- Subjekti të respektojë dhe zbatojë kushtet teknike në objekt për mbrojtjen nga zjarri dhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme për zjarrëfikset.
- Të kryhet monitorimi i indikatorëve të mjedisit sipas ligjeve në fuqi.
- Si rezultat i realizimit të projektit nuk do të absorbohen ndikime të rëndësishme mjedisore, sociale në shëndetin e njerëzve. Për pasoj ndikimet e parashikuara mund të minimizohen duke zbatuar masat e përmëndura më sipër.
- Nga analiza për identifikimin e ndikimeve rezulton se ndikimi do të jetë i drejtpërdrejtë, i shkaktuar vetëm nga linja e magazinimit dhe shpërndarjes së GLN.
- Është detyrë e zbatuesve të projektit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.
- Është detyrë e Njesise Vendore gjithashtu të zbatojë rigorozisht detyrimet e përcaktuara për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.
- Është detyrë e të gjith kontraktorëve e nënkontraktorëve të ndryshëm si gjatë fazës së depozitimit të GLN të zbatojnë me kujdes detyrimet përkatëse të parashikuara më sipër.

Masa lehtësuese të tjera të kërkuara

- Do të bëhet një menaxhim sa më me eficient të energjisë elektrike, kjo do të çojë në uljen e ndotjeve termike të mikroklimës së zonës si dhe kursim të energjisë elektrike nga përdorimi i makinerive/impianit me eficientë.
- Përcaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën përkatëse.
- Subjekti të kryej aktivitetin për furnizim për mbushje gazi GNL vetëm brenda koordinatave të sipërfaqes së tokës që disponon në pronësi.
- Do të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emëtimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari të mundshme teknike të mjeteve.
- Do të instalohet sistem i ujitjes për mjedisin përreth (varet dhe nga hapësira e planifikuar për gjelbërim si dhe pozicioni që ato do të kenë) si dhe lagia me ujë e rrugicave të brendshme gjatë periudhës Maj-Tetor.
- Linja e Impiantit të instaluar në objekt, do të koluadohet në mënyrë periodike nga teknikë të specializuar dhe çertifikuar për të tilla procese.
- Veglat/Pajisjet/Makinerite e punës që shërbejnë për procese të ndryshme do të zëvendësohen me të reja, sipas jetëgjatësisë së tyre dhe eficientës që kanë në kryerjen e operacioneve depozitimit të GNL.
- Maksimizimi i përdorimit të lëndës së parë
- Ambienti i zyrave dhe pajisjet/mjetet në zonën e shfrytëzuar do të lyhet periodikisht me bojë higjienike dhe antikorrozive, me qëllim plotësimin e kushteve Higjieno-Sanitare.
- Do të bëhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta, të cilat do të jenë; lëndë të aballazheve, letra-kartona, si dhe lëndë organike të prodhuara nga punonjësit dhe klientat, ku këto mbetje do të transportohen rregullisht në vendin e caktuar nga Njesia Vendore, ku firma do të marrë masa për menaxhimin e këtyre mbetjeve të ngurta, do të vendosen në kosha selektive sipas rrymave specifike të mbetjeve.


- Rrjeti elektrike është togëzuar për të shmangur ndonjë shkarkesë elektrike, konform kushteve teknike,
- Zona ku do të realizohen operacioni i magazinimit, shpërndarjes dhe furnizimit për mbushje gazi GNL është e rrethuar, me qëllim për të shmangur hyrjet e paautorizuara të individëve dhe faunës së zonës përreth.
- Janë ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme të mbrojtjes kundra zjarrit. Për të mbrojtur kundër zjarrit të mundshëm që mund të bjerë do të ruhen largësitë mbrojtëse ndaj zjarrit të objektit dhe linjës së magazinimit dhe shpërndarjes të GNL.
- Aktiviteti i disponon infrastrukturën e nevojshme, me distancat e përcaktuara për rrugë kalim të punonjësve, automjeteve, zjarrëfiksive, etj.
- Është ndertuar sistemi i drenazhimit të ujërave teknologjike dhe lëvizjes së ujërave të shiut.
- Do të bëhet trajnimi periodik i punonjësve mbi kushtet e sigurimit teknik gjatë operimit të punës, si dhe të kualifikohen stafi përgjegjës për operimin e punës në objektin e furnizimit për mbushje gazi GNL.

MONITORIMI

Plani i Menaxhimit dhe Monitorimit të Mjedisit

Rolin dhe përgjegjësinë kryesore të monitorimit dhe rehabilitimit të mjedisit e ka investitori, ose në rast delegimi të zbatimit të punimeve, subjekti ndertues/nenkontraktor. Institucionet përgjegjëse për mbikqyrjen janë: Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), Drejtoria Rajonale e Mjedisit (DRM), Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit (ISHMPUT), Njësia e Qeverisjes Vendore (NJQV), Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), si dhe vetë subjekti investitor ose nenkontraktori i zgjedhur për këtë qëllim.

Paraqitja në formë skematike e zinxhirit ndër-institucional përgjegjës për raportimin dhe monitorimin e punimeve ndërtimore dhe të rehabilitimit.



Monitorimi i elementeve mjedisore.

Monitorimi i cilesise se mjedisit dhe i nivelit te elementeve ndotes se tij, shkarkimet ne ajer, ne uje, ne toke dhe demtimi i mjedisit biologjik, kryhet sipas disa kriterëve shkencore per sa i perket vrojttimeve, mbledhjes dhe analizimit te mostrave te ujit dhe te tokes, ndersa per sa i perkete ndotjes se ajrit ai monitorohet direkt ne terren. Procesi i monitorimit synon mbledhjen e te dhenave te nevojshme per te vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror ne ndryshimet e mjedisit, ku ai eshte aktiv.

Objektivat kryesore te monitorimit jane:

- Per te zbuluar ndryshimet dhe per te karakterizuar saktesisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit te burimeve.
- Per te siguruar informacione midis lidhjes se kushteve te burimeve te ndotjes dhe shkaqeve te tyre.
- Per te evidentuar cilesine e mjediseseve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetesor ose ekonomik, me synim per te marre masat e nevojshme per reduktimin e shkarkimeve dhe permiresimin e cilesise se elementeve te mjedisit.
- Per te vleresuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve per menaxhimin e burimeve natyrore te hartuara dhe te ndermarra.

Procesi i monitorimit ne rang individual, sipas ligjit per mbrojtjen e mjedisit, eshte detyre e shoqerise investitore/operatorit te pajisur me leje mjedisi ose e nenkontraktorit te zgjedhur per kete qellim, per elementet ne te cilat ai ndikon. Sipas VKM Nr.1189. date 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit" pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 mund te monitorohen nga vete investitori. Monitorimi te kryhet per shkarkimet ne ajer, zhurmat, cilesine e burimeve ujore, si dhe per punimet e rehabilitimit.

Bazuar ne Ligjin Nr 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, Kreu VI, Monitorimi i Gjendjes së Mjedisit, Seksioni 2, Monitorimi i Përputhshmërisë, Neni 44, Detyrimet e operatorit për monitorimin e përputhshmërisë janë:

- Operatori i veprimtarive, të përfshira në kategoritë A, B dhe C, të referuara në nenin 29 të këtij ligji, monitoron shkarkimet e veprimtarisë së tij, në përputhje me dispozitat e legjislacionit për lejet e mjedisit dhe kushtet e përcaktuara në lejen përkatëse të mjedisit.
- Operatori i referuar në pikën 1 të këtij neni monitoron burimet e shkarkimit të veprimtarisë së vet dhe kryen monitorime të tjera, duke përdorur pajisje dhe instrumente të miratuara, përmes procedurës për verifikimin e matjeve, të parashikuara në legjislacionin e posaçëm dhe në pajtim me kushtet e përcaktuara në lejen përkatëse të mjedisit, si dhe mban këto pajisje e instrumente në një gjendje të përshtatshme pune.
- Operatori mund të kryejë monitorimin nëpërmjet pajisjeve dhe instrumenteve të akredituara që ai disponon ose nëpërmjet laboratorëve të specializuar e të akredituar.
- Rezultatet e vetëmonitorimit u jepen autoriteteve përkatëse në përputhje me legjislacionin për lejet mjedisore dhe me kushtet e përfshira në lejen përkatëse mjedisore.

Procesi i Monitorimit

Kërkesa ligjore për kryerjen e monitorimit:

- Ligji nr. 10431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", kreu VI "Monitorim i gjendjes së mjedisit";
- Ligjin Ligji Nr 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", i ndryshuar

Baza ligjore për monitorim

| | |
|---------------------------------|--|
| Ligji nr. 10431 datë 09.06.2011 | "Për mbrojtjen e mjedisit", kreu VI "Monitorim i gjendjes së mjedisit"; |
| Ligji Nr 10448, date 14.07.2011 | "Per lejet e mjedisit", i ndryshuar |
| Ligji Nr.10266 datë 15.4.2010 | Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja |
| Ligji Nr. 9774 datë 12.07.2007 | Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në Mjedis |
| VKM Nr.1189 datë 18.11.2009 | Për Rregullat dhe Procedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit |
| VKM Nr. 435, datë 12.09.2002 | Për miratimin e normave të shkarkimeve ne ajër në Republikën e Shqipërisë |
| VKM Nr. 803 datë 04.12.2003 | Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit |
| Udhëzimi Nr.8 datë 27.11.2007 | Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara |
| VKM Nr. 177, datë 31.3.2005 | Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse |
| VKM Nr. 123, datë 17.2.2011 | Per menaxhimin e zhurmave |
| VKM Nr. 313, dt. 09.05.2012 | Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis |

Monitorimi është detyrë e shoqërisë investitore në nivel individual për pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 të Vendimit Nr.1189. datë 18.11.2009 "Për monitorimet në Republikën e Shqipërisë".

Frekuenca e monitorimeve do të përcaktohet sipas kuadrit ligjor, ku operatori i nje leje mjedisi te tipit B, duhet te kryej vetemonitorimin e ndikimeve ne mjedis te aktivitetit dhe i raporton ato rregullisht te pakten dy here ne vit prane AKM-se. Gjithashtu, raportimi periodik permban edhe informacion per masat e marra per mbrojtjen e mjedisit.

ASPEKTET MJEDISORE DHE TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME

"Teknikat më të mira të disponueshme (TMD)" është stadi më efektiv dhe më i përparuar i zhvillimit të veprimtarive dhe të metodave të operimit të tyre. Ky stad tregon se sa të përshtatshme janë praktikisht teknikat e veçanta për të siguruar, në parim, bazën për të përcaktuar vlera kufi të shkarkimeve, të tilla që të parandalojnë dhe, kur nuk është praktikisht e mundur, të pakësojnë shkarkimet në përgjithësi dhe ndikimin mbi mjedisin në tërësi.

Për qëllime të këtij përkufizimi, me termat e mëposhtëm kuptojmë:

- "Teknikë" është teknologjia dhe mënyra me të cilën instalimi është projektuar, ndërtuar, mirëmbajtur dhe çmontuar;
- "Teknikë e disponueshme" janë teknikat e zhvilluara në atë nivel që mundëson përdorimin e tyre, në sektorin përkatës industrial, me rezultate të mira ekonomike e teknike. Vlerësimi i teknikave merr parasysh kostot dhe përparësitë, pavarësisht nga fakti nëse ato teknika përdoren apo prodhohen në Republikën e Shqipërisë, për sa kohë ato janë të arritshme nga përdoruesi;
- "Më e mirë", në lidhje me teknikat, është teknika më efektive për arritjen e një niveli të lartë të përgjithshëm të mbrojtjes së mjedisit në tërësi.

Aktiviteti objekti i kësaj leje mjedisore, sipas deklaratimit të investitorit, ka dhe zbaton teknikat me të mira të disponueshme për këto lloje instalimi.

PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT

Sipas deklaratimeve të subjektit investitor, do të aplikohen vazhdimisht teknologjite dhe metodat me të mira të disponueshme, do të përdoren mjete dhe materiale miqësore me mjedisin, do të menaxhohen të gjitha mbetjet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, do të aplikohet efikasiteti dhe lartësi energjike, do të reduktohen shkarkimet në mjedis përmes metodave të kontrollit dhe masave për minimizimin e impakteve, etj.

PËRSHKRIMI I MASAVE TË TJERA PARANDALUESË TË PLANIFIKUARA

Masa të tjera lehtësuese, për funksionimin eficient dhe të sigurtë të punës në aktivitetin e furnizimit për mbushje gazi GLN:

- Të mirëmbahen mjediset e gjelbëruar në mënyrë të përhershme dhe të mbillen edhe bimë dekorative autoktone në kushte artificiale për të rritur koeficientin e gjelbërimit.
- Të shmanget në maksimum përdorimi i mjeteve të transportit kur nuk është e nevojshme dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.
- Të kryhet rrethimi i objektit dhe linjës së magazinimit dhe furnizimit të GLN, si dhe të vendosen tabela paralajmëruese për rreziqet për kalimtarët dhe punonjësit.
- Të reduktohet qarkullimi në orët e pikut të trafikut, për të mos krijuar trafik të rënduar në zonë.
- Të mos përdoren boritë e mjeteve në qendrat e banuara dhe qarkullimi të kryhet me shpejtësi të ulët.
- Të vendosen kontener për mbajtjen pastër të ambjentëve nga mbetjet urbane për numrin e punonjësve.
- Investitori të respektojë detyrimet e vendosura në Lejen Mjedisore që do të miratohet nga AKM.
- Subjekti të respektojë të gjitha masat/normat/planet/shkarkimet e deklaruara në këtë Formular-Kërkese për Leje Mjedisore Tipi B.
- Subjekti të jetë në dijeni dhe të azhurnohet për kuadrin ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.
- Subjekti të respektojë dhe zbatojë kushtet teknike në objekt për mbrojtjen nga zjarri dhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme për zjarrëfikset.
- Të kryhet monitorimi i indikatorëve të mjedisit sipas ligjeve në fuqi.

- Si rezultat i realizimit të projektit nuk do të absorbohen ndikime të rëndësishme mjedisore, sociale në shëndetin e njerëzve. Për pasoj ndikimet e parashikuara mund të minimizohen duke zbatuar masat e përmëndura më sipër.
- Nga analiza për identifikimin e ndikimeve rezulton se ndikimi do të jetë i drejtpërdrejtë, i shkaktuar vetëm nga linja e magazinimit dhe shpërndarjes së GLN.
- Është detyrë e zbatuesve të projektit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.
- Është detyrë e Njesise Vendore gjithashtu të zbatojë rigorozisht detyrimet e përcaktuara për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.
- Është detyrë e të gjithë kontraktorëve e nënkontraktorëve të ndryshëm si gjatë fazës së depozitimit të GLN të zbatojnë me kujdes detyrimet përkatëse të parashikuara më sipër.

Masa lehtësuese të tjera të kërkuara

- Do të bëhet një menaxhim sa më me eficient të energjisë elektrike, kjo do të çojë në uljen e ndotjeve termike të mikroklimës së zonës si dhe kursim të energjisë elektrike nga përdorimi i makinerive/impianit me eficientë.
- Përcaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën përkatëse.
- Subjekti të kryej aktivitetin për furnizim për mbushje gazi GNL vetëm brenda koordinatave të sipërfaqes së tokës që disponon në pronësi.
- Do të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emëtimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari të mundshme teknike të mjeteve.
- Do të instalohet sistem i ujitjes për mjedisin përreth (varet dhe nga hapësira e planifikuar për gjelbërim si dhe pozicioni që ato do të kenë) si dhe lagia me ujë e rrugicave të brendshme gjatë periudhës Maj-Tetor.
- Linja e Impianit të instaluar në objekt, do të kolaudohet në mënyrë periodike nga teknikë të specializuar dhe çertifikuar për të tilla procese.
- Veglat/Pajisjet/Makinerite e punës që shërbejnë për procese të ndryshme do të zëvendësohen me të reja, sipas jetëgjatësisë së tyre dhe eficientës që kanë në kryerjen e operacioneve depozitimit të GNL.
- Maksimizimi i përdorimit të lëndës së parë
- Ambienti i zyrave dhe pajisjet/mjetet në zonën e shfrytëzuar do të lyhet periodikisht me bojë higjienike dhe antikorrozive, me qëllim plotësimin e kushteve Higjieno-Sanitare.
- Do të bëhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta, të cilat do të jenë; lëndë të aballazheve, letra-kartona, si dhe lëndë organike të prodhuara nga punonjësit dhe klientat, ku këto mbetje do të transportohen rregullisht në vendin e caktuar nga Njesia Vendore, ku firma do të marrë masa për menaxhimin e këtyre mbetjeve të ngurta, do të vendosen në kosha selektive sipas rrymave specifike të mbetjeve.
- Rrjeti elektrik është togëzuar për të shmangur ndonjë shkarkesë elektrike, konform kushteve teknike,

- Zona ku do të realizohen operacioni i magazinimit, shperndarjes dhe furnizimit per mbushje gazi GNL eshte e rrethuar, me qëllim për të shmangur hyrjet e paautorizuara të individëve dhe faunës së zonës përreth.
- Janë ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme të mbrojtjes kundra zjarrit. Për të mbrojtur kundër zjarrit të mundshëm që mund të bjerë do të ruhen largësitë mbrojtëse ndaj zjarrit të objektit dhe linjës së magazinimit dhe shperndarjes te GNL.
- Aktiviteti i disponon infrastrukturën e nevojshme, me distancat e përcaktuara për rrugë kalim të punonjësve, automjeteve, zjarrëfiksive, etj.
- Eshte ndertuar sistemi i drenazhimit te ujrave teknologjike dhe lëvizjes së ujërave të shiut.
- Do të bëhet trajnimi periodik i punonjësve mbi kushtet e sigurimit teknik gjatë operimit të punës, si dhe të kualifikohen stafi përgjegjës për operimin e punës në objektin e furnizimit per mbushje gazi GNL.

REHABILITIMI, NDËRPRERJA E VEPRIMTARISË, RIFILLIMI DHE KONTROLLI PAS NXJERRJES NGA PËRDORIMI

Nderprerja perfundimtare e veprimtarise, apo transferimi i aktivitetit ne nje vendodhje tjeter, sjell si rrjedhoje nevojën per mbylljen dhe rehabilitimin e mjedisit. Ne lidhje me kete hartohet nje plan per mbylljen dhe rehabilitimin qysh ne faze te hershme kur operatori pajiset me leje mjedisi dhe e rishikon ate ne momentin e mbylljes dhe zbatimit te ketij plani. Ne lejen mjedisore te tipit B, ky proces parashikohet ne kushtin nr. 14 te lejes se mjedisit. Plani i mbylljes dhe rehabilitimit konsiston ne keto procese: Çmontimi i pajisjeve/makinerive, transporti i tyre ne vendodhjen e re, ose per ne pikat e riciklimit/asgjesisimit ne rast se nuk do te riperdoren. Instalimi ne vendodhjen e re ne rast se aktiviteti transferohet.

Objekti ne te cilin do te zhvillohet aktiviteti, eshte objekt ekzistues, eshte ne gjendje te mire dhe plotesisht funksional, nuk do te kryhet rikonstrukcion dhe ne rast çmontimi, nuk do te kete prishje te objektit dhe rehabilitim te mjedisit natyror. Gjate zhvillimit te aktivitetit subjekti nuk do te kryej asnje nderhyrje ne strukturen e objektit. Ky objekt merret me qera nga investitori dhe ne mbyllje te aktivitetit dhe çmontimit te instalimit do ti kaloje serish ne menaxhim pronarit ligjor te tij. Nuk do te kete mbyllje dhe rehabilitim te objektit. Do te kete vetem largim te pajisjeve.

| Preventivi i mbylljes se aktivitetit, çmontimit dhe rehabilitimit | | |
|--|-------------------------|-------------------------|
| Nr. zerave te punimeve | Zerat e punimeve | Kosto financiare |
| 1 | Kosto çmontimi | _____ leke |
| 2 | Kosto transporti | _____ leke |
| 3 | Kosto rinstalimi | _____ leke |

PLANI I MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Aktiviteti qe zhvillon shoqeria " DORI GAZ ", Pike gazi e ndodhur ne Qarku Vlore, Bashkia Vlore, lagjja Kushtrimi, rruga "Dervish Hekali", Objekt nr.34/171 nga proceset e ndryshme te operimit te punes ne objekt per magazinimin, shperndarjen dhe furnizimin me gaz te lengshem GLN dhe gjenerohet nje sasi mbetjesh.

Lendet e para/produktet qe perdoren ne kete aktivitet jane vetem Gazi i Lengshem i Naftes (kryesisht Propan), ndersa materia let ndihmese jane energjia elektrike. Persa i perkete menaxhimit te Gazit GLN, ruhet dhe magazinohet e tregtohet ne menyre te sigurte nga subjekti qe menaxhon kete aktivitet. Kjo do te thote se te gjitha enet qe perdoren, pra depozitat, jane ene te prodhuara per te punuar nen presion kaq te larte dhe jane te kolauduara nga Inspektoriati Qendror Teknik (IQT). Ky sistem eshte i pajisur me valvula sigurie dhe te kontrollimit te presionit, duke shmangur keshtu shkarkimin e gazit ne atmosfere dhe duke krijuar sigurine tek punonjesit dhe klientet. Bombulat qe mbushen plotesojne kriteret baze te sigurise teknike dhe certifikohen per sigurine tyre vazhdimisht nga organet pergjegjese.

Mbetjet e ngurta qe prodhohen ne kete aktivitet jane mbetjet e ngurta urbane te tilla si Plastmas, Plasike HDPE, Karton, Leter, Qelq, Metale.

Keto mbetje hidhen ne kontenierin e mbetjeve te ngurta urbane, ku pastrohen cdo dite nga firma pastruese e zones e cila permes bashkepunimit me NJQV-ne, per firmat e kontraktuara ne

grumbullimin e mbetjeve urbane, reduktimin dhe riciklimin e mbetjeve, ne ndertimin e nje infrastrukture te qendrueshme ne diferencimin e mbetjeve, duke maksimizuar dobine e Landfillit Rajonal (ku kryhet dhe asgjесimi perfundirntar i tyre, sipas Strategjise Kornbetare te Mjedisit per Menaxhimin e Mbetjeve).

Aktiviteti nuk shkarkon mbeteje te ngurta as te lengeta ne mjedisin e zones.

Objektivat afatshkurtra dhe afatmesme të planit janë si më poshtë:

- Instalimi i sistemit me 3-kontenier brenda zones ku zhvillohet aktiviteti
- Diferencimi i mbetjeve, sipas tre rrymave prioritare (Plastik, Letër/Karton dhe Mbetje të tjera)
- Transportimi i mbetjeve të ngurta urbane në vendepozitimin e caktuar nga Njësia Vendore.

Synimet:

- Përmirësimi i cilësisë së mjedisit, grumbullimin e mbetjeve në të gjithë territorin e objektit dhe diferencimin e mbetjeve sipas tre rrymave kryesore
- Organizimi i diferencuar i mbetjeve në përputhje me politikat kombëtare, për të mundësuar dhe stimuluar metodat e trajtimit të mbetjeve (riciklimi dhe riperdorim)
- Planifikimi dhe ngritja në nivelin zonal i një rrjeti të kontenierëve për diferencimin e mbetjeve me qëllim për të maksimizuar dobinë e Landfillit Rajonal
- Maksimizimi i përdorimit të mbeteve urbane dhe mbetjeve teknologjike

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE E NDIKIMEVE NE MJEDIS**Shkarkimet ne uje**

Nje ndikim tjetër i pranishëm në objektin ku zhvillohet aktiviteti është dhe menaxhimi i ujrave, Ujrat e gjeneruara nga proceset e pastrimit, larjes dhe sprucimit të depozitave gjatë stinës së thatë, grumbullohen në rrjetin e brendshme të kanalizimeve dhe perfundojnë në rrjetin e kanalizimeve të zonës.

Emetimet ne ajer

Emetimet në ajër mund të vijnë nga përhapja e gazit të lëngshëm të naftës në atmosferë, si rrjedhojë e ndonjë avarie në sistem dhe në valvolat e sigurisë, ose nga aktiviteti i mbushjes së bombulave, gjithmone një sasi e vogël cirohet në ajër nga rezerva e pistoletës furnizuese. Gjithashtu të pranishme në терминаlet e shkarkimit janë edhe aromat e gazit (sqfur), të cilat janë të pashmangshme edhe pse shoqëria ka marrë masat e nevojshme për reduktimin në maksimum të këtyre shkarkimeve.

Ndikimi ne Biodiversitet

Kjo zonë nuk bën pjesë në zonat e ndjeshme të zonave të mbrojtura me ligj, as lloji i aktivitetit nuk ndikon në biodiversitet. Aktiviteti ndodhet në zone të urbanizuara dhe nuk ka shtrirje në natyrë.

Mbetjet e prodhuara

Mbetjet që gjenerohen nga procesi i shpërndarjes dhe magazinimit të gazit GLN, si dhe nga aktiviteti i perdritshme i aktivitetit të punonjësve konsistojnë në gjenerimin e mbetjeve urbane nga punonjësit. Mbetjet urbane grumbullohen në fraksione të ndara duke përdorur sistemin me tre kosha të l-leter dhe karton, plastike dhe qelqë, 2-metale, kanace etj dhe 3- të thata dhe të kompostueshme.

▪ **PËRMBLEDHJEN JOTEKNIKE TË RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS NË NIVEL KOMBËTAR OSE NDERKUFITAR, KUR KËRROHET PROCEDURA E VNM-SË;**

Bazuar në Ligjet e mbrojtjes së mjedisit, ky aktivitet përfshihet në listat e aktiviteteve të cilat duhet të pajisen me leje mjedisore të tipit B, por nuk listohet ndër aktivitetet të cilat duhet të nënshtrohen procedurës së VNM Paraprake ose të thelluar.

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis, hartohet për të informuar publikun dhe institucionet e mbrojtjes së mjedisit mbi ndikimet në mjedis të aktivitetit.

(Ref. Ligji Nr. 10440 datë 07.07. 2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", i ndryshuar, dhe Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit", i ndryshuar.).

▪ **KONSULTIMET NDERKUFITARE, KUR KËRROHET SIPAS LEGJISLACIONIT NË FUQI;**

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhojë edhe ndikimi i tij nuk shkakton demtim të mjedisit nderkufitar. Projekti nuk ndikon në cenimin e sigurisë së jetës dhe shëndetit të shteteve fqinje, madje në kushte normale, as të qendrave të banuara të rajonit. Nuk ndikohen burimet ujore nderkufitare, nuk ndikohet cilesia e ajrit në kontekstin nderkufitar. Për këtë kapitull, nuk kryhen vlerësime dhe analiza të detajuara për shkak të vendodhjes së projektit në brendësi të kufirit shtetëror dhe distancës që ai ruan me kufirin dhe shtet fqinje. Për këtë projekt nuk kryhen konsultime nderkufitare.



- **AUTORITETIN VENDIM-MARRËS PËR DHËNIEN E AKTIT TË MIRATIMIT TË LEJES SË MJEDISIT, PROCEDURAT DHE AFATET QË DO TË NDIQEN;**
Autoritetet vendim-marrese per lejen e mjedisit te tipit B jane Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit.



Afatet dhe procedurat per lejen e mjedisit te tipit B, janë sipas Kreut III, pika 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 10 e VKM nr. 419, datë 25.6.2014 e ndryshuar.

KREU III

PROCEDURAT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE PËRCAKTIMI I KUSHTEVE PËR LEJE MJEDISI TË TIPIT B.

1. Kërkuesi që aplikon pranë QKL-së për pajisjen me leje mjedisi të tipit B duhet të dorëzojë këto dokumente:

- a) Formularin informues për pajisje me leje mjedisi të tipit B, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij vendimi;
 - b) Mandatpagesën për tarifën përkatëse për lejen e mjedisit të tipit B, sipas nenit 25 të ligjit nr.10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit";
 - c) Çdo informacion tjetër që kërkuesi i lejes kërkon të merret parasysh gjatë shqyrtimit të aplikimit;
 - ç) Kopjen e vendimit të AKM-së për VNM-në paraprake ose kopje të deklaratës së ministrit për VNM-në e thelluar, të shoqëruar me raportin paraprak ose të thelluar të VNM-së, në rastet kur për instalimin është kryer procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas përcaktimit në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis".
 - d) Raportin mbi sigurinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e rreziqeve nga aksidentet madhore, kur kërkohet.
 - dh) Relacionin rreth dëgjësës me publikun, sipas përcaktimit në pikën 13 të kreut V të këtij vendimi.
2. AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit për leje mjedisi të tipit B nga QKLja, dërgon një kopje të aplikimit në institucionet e mëposhtme, të cilët japin mendimin e tyre, me shkrim dhe në formë elektronike, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune:
- a) Drejtoritë teknike në Ministrinë e Mjedisit, sipas specifikave të instalimit;
 - b) Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave (ISHMPU);
 - c) Agjencinë Rajonale të Mjedisit (ARM).
3. Nëse institucionet e përcaktuara në pikën 2, të këtij kreu, nuk shprehën brenda afatit, AKM-ja vijon me procedurën.
4. AKM-ja, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, pas verifikimit për saktësinë e dokumentacionit të aplikimit për lejen e mjedisit të tipit B dhe mbledhjes së mendimeve nga publiku e institucionet e përmendura në pikën 2, të këtij kreu, harton aktin e miratimit/refuzimit për dhënien ose jo të lejes së mjedisit të tipit B, të shoqëruar me argumentet përkatëse, dhe e dërgon tek ministri.
5. Ministri, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes, firmos aktin e miratimit/refuzimit të lejes së mjedisit të tipit B ose ia kthen praktikën AKM-së për shtesa apo ndryshime të këtij akti, të shoqëruar me argumentet përkatëse.
6. AKM-ja, brenda afatit të përcaktuar në këtë vendim, publikon vendimin e miratimit ose të refuzimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve për leje mjedisi të tipit B.
10. Afati total për publikimi e vendimit të miratimit ose refuzimit të aplikimit për pajisjen me leje mjedisi të tipi B në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, nga data e marrjes së aplikimit nga Qendra Kombëtare e Licencimit, është 40 (dyzet) ditë pune.

- **ADRESËN E AKM-SË, KU PUBLIKU MUND TË DËRGOJË KOMENTET DHE SUGJERIMET E TIJ, ME SHKRIM APO NË FORMË ELEKTRONIKE, BRENDË 20 (NJËZET) DITËVE NGA DATA E NJOFTIMIT.**

Web:

<https://akm.gov.al>

Poste elektronike Email:info@akm.gov.al

Adrese postare: Tiranë, rruga "Sami Frashëri", Nr. 4,